

## **Hapet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Graz-it në Austri për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Graz-it, në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e UT-së për studime, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.uni-graz.at/de/>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;

### **Fushat e shkëmbimit:**

- Fizikë (vetëm studentët e nivelit Master);
- të gjitha fushat e tjera të përbashkëta (Bachelor dhe Master).

\*Studentët e vitit të tretë Bachelor dhe studentët e vitit të dytë Master nuk mund të aplikojnë.

Për informacion mbi katalogun e kurseve referohuni linkut:

[https://online.uni-graz.at/kfu\\_online/wbENLVSuche.wbEnLvSuchePage](https://online.uni-graz.at/kfu_online/wbENLVSuche.wbEnLvSuchePage)

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (5 muaj);
- Master (5 muaj).

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

-CV (në gjuhën angleze / gjermane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);

-Listë notash bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze / gjermane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2 / Gjermanisht B2 në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the Mobility". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Graz-it lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti kryen ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, dokumenti nuhet firmosur në të njëjtën mënyrë në pjesën ‘‘during mobility’’.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Learning\\_Agreement\\_Graz.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Learning_Agreement_Graz.docx)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

-CV (në gjuhën angleze / gjermane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);

-Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze ose gjermane);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze / gjermane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2 / Gjermanisht B2 në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të*

*merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Graz-it lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse studenti kryen ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, dokumenti nuhet firmosur në të njëjtën mënyrë në pjesën “during mobility”.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Learning\\_Agreement\\_Graz.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2021/03/Learning_Agreement_Graz.docx)

**Afati për aplikim: 20 Prill 2021**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!